

VENDIM
Nr. 255, datë 9.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURE E TË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË SPORTIT

(ndryshuar me VKM nr. 25, datë 17.1.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, me propozimin e *Ministritë përgjegjëse për sportin*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes strukturore të Këshillit të Lartë të Sportit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sportin dhe ka në përbërje të tij 12 (dymbëdhjetë) anëtarë dhe 1 (një) sekretar, si më poshtë vijon:

- a) Përfaqësuesi i *ministritë përgjegjëse për sportin* anëtar;
 - a/ 1) Përfaqësuesi i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar anëtar;
 - a/ 2) Përfaqësuesi i Organizatës Kombëtare Shqiptare Anti Doping anëtar;
- b) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Futbollit anëtar;
- c) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Basketbollit anëtar;
- ç) Përfaqësuesi i Federatës Shqiptare të Volejbollit anëtar;
- d) Përfaqësuesi i Universitetit të Sporteve të Tiranës anëtar
- dh) Përfaqësuesi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë anëtar;
- e) Dy personalitete të sportit anëtarë;
- ë) Një jurist anëtar;
- f) Një gazetar sportiv anëtar;
- g) Një specialist nga MAS sekretar.

2. Përbërja nominative e Këshillit të Lartë të Sportit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

3. Këshilli i Lartë i Sportit thirret si rregull nga ministri përgjegjës për sportin, jo më pak se 3 (tri) herë në vit.

4. *Ministria përgjegjëse për sportin* miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit.

5. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Sportit shpërblehen për pjesëmarrjen në mbledhje, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

6. Vendimi nr. 437, datë 2.7.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes strukturore e të shpërblimit të Këshillit Kombëtar të Sportit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet *Ministria përgjegjëse për sportin* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama